

Bazuar në nenin 36 paragrafi 1, nënparagrafi 1.17 dhe nenin 65 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr. 03/L-209 Për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, nenin 4, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 05/L-045 për Sigurimet, nenin 42 të Ligjit nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia dhe në zbatim të neneve 4, 5, 6 dhe 8 të Rregullores për Fondin e Kompensimit të Byrosë Kosovare të Sigurimeve, Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datë 9 mars 2016, nxjerrë këtë:

### **UDHËZIM Nr. 01/2016**

#### **Mbi ndarjen e rezervave dhe financimin e fondit të kompensimit të Byrosë Kosovare të Sigurimit**

##### **Neni 1**

##### **Qëllimi dhe fushëveprimi**

Qëllimi i këtij udhëzimi është vendosja e standardeve për përcaktimin e ndarjes së rezervave teknike dhe financimin e fondit të kompensimit për siguruesit e licencuar, që operojnë në Republikën e Kosovës.

##### **Neni 2**

##### **Ndarja e rezervave dhe financimi i fondit të kompensimit**

1. Financimi i fondit të kompensimit duhet të bëhet në pajtim me nenin 32 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia dhe nenin 4 të Rregullores për fondin e kompensimit të Byrosë Kosovare të Sigurimit.
2. Siguruesit, në fillim të çdo viti duhet të ndajnë një rezervë dhe të pasqyrojnë atë në bilancin e gjendjes si rezervë për Fondin e Kompensimit.
3. Rezervat teknike ndërtohen në baza tremujore, dhe ndahen në mes siguruesve sipas përqindjeve të pjesëmarrjes në treg të siguruesve, nga primet e sigurimeve të detyrueshme nga autopërgjegjësia, në tremujorin kur ka ndodhur aksidenti.
4. Fondi i kompensimit ndërtohet në baza tremujore, bazuar në kontributin e siguruesve nga pjesëmarrja e primeve të tyre në sigurimet e detyrueshme gjatë tremujorit paraardhës.

5. Çdo fund tremujori, rezerva teknike do të krijohet për detyrimet e fondit të kompensimit të atij tremujori, derisa rezervat teknike për tremujorët e mëparshëm (apo vjetore) të jenë të krijuara tashmë.
6. I njëjti parim, sikurse në pikën 4, do të vlejë edhe tek pagesa e dëmeve, që d.m.th që pagesat e dëmeve do të bëhen duke u bazuar në kontributet e secilit sigurues në tremujorin kur ka ndodhur aksidenti.
7. Për siguruesit e rinj të licencuar që operojnë në treg, merren parasysh rezervat e krijuara të dëmeve, nga data e licencimit të tyre nga BQK-ja dhe anëtarësimit në Byronë Kosovare të Sigurimit.
8. Me rastin e likuidimit të një siguruesi, dhe në rastet kur asetet e këtij siguruesi nuk janë të mjaftueshme për kryerjen e obligimeve të saj, atëherë data e tërheqjes së siguruesit nga tregu do të konsiderohet si datë për llogaritjen e rezervave teknike të fondit të kompensimit për të gjithë siguruesit, sipas pjesëmarrjes në treg.

### **Neni 3 Shtojca**

Për qëllime të zbatimit të këtij Udhëzimi, pjesë përbërëse e tij është shtojca 1 që përmban shembullin praktik të mënyrës së ndarjes së rezervave dhe financimit të fondit të kompensimit.

### **Neni 4 Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim hyn në fuqi në datën e miratimit.

  
Bedri Hamza

Kryesues i Bordit Ekzekutiv

## Shtojca 1

### **Shembull:**

Nëse një dëm që ka ndodhur në vitin 2014 do të paguhet në vitin 2016, pagesa e dëmit nga Fondi i Kompensimit do të bëhet bazuar në përqindjen e kontributeve të çdo siguruesi në vitin 2014. Si shembull hipotetik, nëse për këtë dëm është ndarë rezerva 10,000 euro, dhe në vitin 2014 kanë qenë 5 sigurues, secila me pjesëmarrje prej 20%, ndarja e rezervës teknike për secilin sigurues do të jetë 2,000 euro. Nëse me rastin e pagesës së të njëjtit dëm, në vitin 2016, pagesa e dëmit rritet në 20,000 euro, atëherë pavarësisht numrit të siguruesve në tregun e sigurimeve, 5 kompanitë që kanë qenë aktive në vitin 2014, kur ka ndodhur aksidenti, do të bëjnë pagesën e dëmit, sipas pjesëmarrjes në treg në vitin 2014, pra nga 4,000 euro.